



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:288074

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06788911

P.nr.1030/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË P. – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Dardan Tolaj, në çështjen penale kundër të pandehurit Hysni Nikqi, nga P., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Vjedhja” nga neni 313 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P., Departamenti i Përgjithshëm nën shenjë PP/II.nr.2512/2021 të dt.21.12.2021, pas mbajtjes së seancë të shqyrtimit fillestar me datë 26.12.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Ermal Demhasaj, të pandehurit Hysni Nikqi nga P., me datë 27.12.2024 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

HYSNI NIKQI, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, i lindur me datën në P., ku edhe banon në rr „M. Sh.” nr....., nga i ati R.dhe e ëma F., e vajzërisë B., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, beqar, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar me pare nga gjykata, Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Me datën, rreth orës 19:00, në P. në rrugën M. Sh. me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) euro apo më shumë, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri Hysni shkon në vendin e lartëcekur dhe aty nga oborri i shtëpisë e merr rimorkion, pronë e të dëmtuarit N. B. dhe pastaj të njëjtën ia shet personit tjetër në vlerë prej 70 euro,

- me çka ka kryer veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 69, 70, nenit 313 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPP-së, gjykata të pandehurit Hysni Nikqi i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

- I.** Në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. DËNIM ME GJOBË** shumën në lartësi prej njëqind e pesëdhjetë (150) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku 20 € (njëzet euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.
- IV.** I pandehurit obligohet gjykatës t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor shumën prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- V.** I pandehurit obligohet ta paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

VI. Pala e dëmtuar N. B. me vendbanim në P., në rr., „Gjin Gazuli”, nr B2/3 udhëzohet në kontest civil për realizim të kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në P.-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën, PP/II.nr.2512/2021 të dt.21.12.2021, kundër të pandehurit Hysni Nikqi nga P., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprë penale „Vjedhja” nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 26.12.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit, Ermal Demhasaj dhe të pandehurit Hysni Nikqi nga P..

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata e bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke i udhëzuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, konform dispozitës së nenit 241 par.4 të KPPRK-së.

I pandehuri Hysni Nikqi, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, vullnetarisht dhe pa asnjë presion pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi është bërë në mënyrë vullnetare, me vetëdije të plotë, duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe meqenëse ka mbështetur në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e tij është bërë vullnetarisht konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit A. Sh. dt.26.09.2021; Procesverbal i marrjes

në pyetje të të dëmtuarit N. B. dt.26.09.2021; Procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit M. A. dt.26.09.2021; Procesverbal i të dyshuarit Hysni Nikqi dt.26.09.2021; Procesverbal i dëshmitarit E. K. dt.26.09.2021.

Prokurori i shtetit lidhur me caktimin e dënimit i propozoi gjykatës, që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese dënimet e mëparshme të të pandehurit.

Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të pandehurit, pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Hysni Nikqi, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Vjedhja ” nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjykata gjatë procedurës penale nuk gjeti rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata, për vendimin mbi dënim ka vendosur pasi që i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, ka vlerësuar faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë , ndërsa si rrethanë rënduese gjykata morri parasysh dënimet e plotfuqishme të mëparshme të të pandehurit pasi që i njëjti ka dy aktgjykime të formës së prerë dhe atë: P.nr.196/2016 të datës 28.04.2016 për veprën penale "mundësimi apo detyrimi në prostitucion" nga neni 241 të KPRK-së për të cilin është dënuar me dënim me burg dhe P.nr.14/2019 të datës 28.04.2016 për veprën penale "blerja, posedimi,

shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope ose analoge" nga neni 273 të KPRK-së për të cilin po ashtu është dënuar me dënim me burgim.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit. Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së, gjykata të dëmtuarin N. B. me vendbanim në P., në rr., „Gjin Gazuli”, nr B2/3, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE P.

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM/Divizioni Penal

P.nr.1030/2021, me datë 26.01.2025

Praktikanti gjyqësor

Gjyqtare e vetme gjykuese

Dardan Tolaj

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

